

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.03.2023*

15.03.2023
Ora 09:16

RENDI I DITËS

Hedhja e shortit “Për caktimin e relatorit të Kërkesës Ankimore nr. 32 me objekt “shfuqizimi i vendimit nr. 172, dt. 14.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Demokratike për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023 ””.

PJESËMARRJA :

- Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, Z. E. Mema, Znj. I. Osmanaj

Z. Y. Merkaj: Përshëndetje të gjithëve! Sot, në datën 15 .03.2023 do të zhvillohet procedura e hedhjes së shortit për caktimin e relatorit, për kërkesën ankimore nr. 32, me ankues Partia Demokratike e Shqipërisë, me objekt “Kundërshtimin e vendimit nr. 172. dt. 14.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Demokratike për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023 ” . Procedura e shortit është parashikuar në nenin 14 të rregullores së KAS-it. Për këtë kemi përgatitur 5 shirita letre, ku në njërin prej tyre është shënuar Kërkesa Ankimore nr. 32, 4 shiritat e tjerë janë të bardhe dhe pa shënime, të cilat do të futen në 5 gogla me peshë , ngjyrë dhe formë të njëjtë nga një përfaqësues i administratës. Të pestë shiritat do të futen në gogla me peshë , ngjyrë dhe formë të njëjtë, në një enë transparente. Përzjehen nga një përfaqësues i KQZ-së. Duke qenë se anëtarët e Kas-it nuk janë të pranishëm, është autorizuar përfaqësuesi i KQZ-së të tërheqë në emër dhe për llogari të tyre goglat për caktimin e relatorit. Vazhdojmë me rendin alfabetik ngjithës duke filluar nga zoti Elvin Lako.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.03.2023*

Për Z. E. Lako: Tërhiqet gogla – Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Për Z. E. Çefa: Tërhiqet gogla – Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Për Z. I. Rusmali: Tërhiqet gogla - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Për Z. K. Bele: Tërhiqet gogla – Kërkesa Ankimore nr. 32.

Për Z. L. Braho: Tërhiqet gogla - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Në përfundim të procedurës së shortit për Kërkesën Ankimore nr. 32, relator është caktuar zoti Koli Bele. Ju faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.03.2023*

15.03.2023
Ora 14:34

RENDI I DITËS

Hedhja e shortit “Për caktimin e relatorit të Kërkesës Ankimore nr. 33 me objekt “Kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 17, dt. 14.03.2023 dhe ndryshimn e vendimit duke vendosur regjistrimin e Partisë Demokratike të Shqipërisë përfaqësuar nga kryetari Sali Berisha, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023 ””.

PJESËMARRJA :

- Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, Z. E. Mema, Znj. I. Osmanaj

Z. Y. Merkaj: Përshëndetje të gjithëve! Sot, në datën 15 mars 2023 ora 14:30, do të zhvillohet procedura e hedhjes së shortit për caktimin e relatorit, për kërkesën ankimore nr. 33, të paraqitur në Komisionin Qendror të zgjedhjeve. Kërkesa ankimore mban si ankues Partia Demokratike e Shqipërisë, me objekt ankimi “Kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 172. dt. 14.03.2023”. Procedura e shortit është parashikuar në nenin 14 të rregullores së KAS-it. Për këtë kemi përgatitur 5 shirita letre, ku në njërin prej tyre është vendosur Kërkesa Ankimore nr. 33 ndërsa 4 shiritat e tjerë janë të bardhë dhe pa shënime. Shiritat e letrës palosen nga një përfaqësues i administratës dhe futen në 5 gogla me peshë, ngjyrë dhe formë të njëjtë, në një enë transparente. Vazhdojmë me shiritat e bardhë. Pasi janë futur të pestë goglat në një enë transparente, duke qenë se anëtarët e Kas-it nuk janë të pranishëm në seancë, një përfaqësues i administratës i autorizuar nga KAS-i tërheq goglat në emër dhe për llogari të tyre,

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.03.2023*

duke filluar nga rendi alfabetik ngjitës me zotin Elvin Lako emrin e parë.
Përzjehen goglat në emër dhe për llogari të zotit Lako.

Për Z. E. Lako: Tërhiqet gogla – Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Për Z. E. Çefa: Tërhiqet gogla – Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Për Z. I. Rusmali: Tërhiqet gogla - Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Për Z. K. Bele: Tërhiqet gogla – Shiriti është i bardhë dhe pa shënime.

Për Z. L. Braho: Tërhiqet gogla - Kërkesa Ankimore nr. 33.

Në përfundim të procedurës së shortit relator i Kërkesës Ankimore nr. 33 është
caktuar zoti Ledio Braho. Ju faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



RENDI I DITËS

Projektvendim "Shqyrtimi paraparak i Kërkesës Ankimore nr. 32, objekti shfuqizimi i vendimit nr. 172, dt. 14.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Subjekti ankues Partia Demokratike e Shqipërisë".

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Z. E. Mema, znj. I. Osmanaj
- **Parti Politike:** PD (I .Sefa, L. Nuraj, F. Nuri)

Z. K. Bele: Çelim sot seancën publike të Komisionit të Ankimimeve dhe të Sanksioneve për të verifikuar elementët e formës dhe të përmbajtjes së ankimit nr. 32, të subjektit ankues Partia Demokratike e Shqipërisë, me objekt “shfuqizimi i vendimit nr. 172, dt. 14.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Demokratike për regjistrimin si subjekt zgjedhor në organet e qeverisjes vendore në zgjedhjet e datës 14.05.2023. Relator i kësaj çështjeje jam zgjedhur unë Koli Bele sipas shortit të hedhur në datën 15 mars 2023. Të pranishëm në seancë janë anëtarët e KAS-it, si dhe administrata e KQZ-së përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm. Ka ndonjë kërkesë? Gjithashtu janë prezent përfaqësuesit e subjektit, të identifikuar...

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Indrit Sefa, përfaqësues i Partisë Demokratike dhe kërkues në vendimarrjen e Komisionerit.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.03.2023*

Z. K. Bele: Ka palë të tjerë?

Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së: Ledio Nuraj, përfaqësues i Partisë Demokratike, Franc Nuri gjithashtu përfaqësues i Partisë Demokratike. Kemi ushtruar në zbatim të kodit të rregullores një kërkesë për marrjen pjesë si palë e interesuar në shqyrtimin e çështjes së ankimit të Partisë Demokratike.

Z. K. Bele: Po zoti Nuri, ne e kemi të administruar një kërkesë të tillë.

Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së: Me pretendimin që...

Z. K. Bele: KAS i konsultuar në vend...

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Në lidhje me legjitimitimin e kërkuarit, sepse referohet si përfaqësues i Partisë Demokratike, ndërkohë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve i vetmi i legjitimuar si përfaqësues i Partisë Demokratike jam unë, si person përgjegjës për komunikimin me KQZ-në në vazhdimësi dhe nuk ka subjekte të tjera në dijeninë time. Në rast se palët mund të legjitimojnë si përfaqësues i ndonjë subjekti tjetër, si kërkuar ose si individ, është diskutim tjetër, por si përfaqësues i Partisë Demokratike nuk mund të legjitimohen në këtë proces.

Z. K. Bele: zoti Sefa ju jeni në dijeni që ne jemi në vazhdim të një procesi të një shqyrtimi administrativ. Është fakt që palët kanë qenë të njëjtat palë në procesin e mëparshëm, dalë përpara KQZ-së dhe në këtë kuptim, në pamje të parë ne kemi një interes të ligjshëm të palës për të qenë pjesë në këtë proces dhe unë mendoj se

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.03.2023*

është në interesin e të gjitha palëve, përfshirë dhe atë tuajën, sigurisht edhe të procesit në rradhë të parë. E njëjta palë e cila ka qenë e përfshirë në fazën e shqyrtimit para Komisionerit të jetë e përfshirë në vazhdimin e procesit në këtë fazë paraprake, besoj kjo është...

Z. I. Rusmali: Po të duan i quajmë personi A personi B, por sikur nuk shkon

Z. K. Bele: Nuk shkon se Komplikohemi.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Jo nuk ka nevojë.

Z. K. Bele: Atëherë KAS i konsultuar në vend vendosi pranimin e palës kërkuese, të përfaqësuar nga zoti Ledio Nuraj dhe Franc Nuri për të qenë pjesë e shqyrtimit administrativ. Ka ndonjë kërkesë tjetër paraprake në këtë fazë, lidhur me trupin, i cili po vlerëson këtë?

Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së: Dakord me trupin gjykues.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Jo nuk kemi asnjë kërkesë, pasi KAS-i ka mbajtur një qendrim në lidhje me kërkesat tona të parashtruara në mbledhjen e parë, kështu që...

Z. E. Lako: Ekonomia administrative dhe për të kursyer lekët e taksapaguesve shume mirë që...

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.03.2023*

Z. K. Bele: Mirë faleminderit! Fjalën e ka përfaqësuesi i KQZ-së, zoti Merkaj për të bërë një parashtrim të shkurtër të rrethanave dhe të fakteve.

Z. Y. Merkaj: Vendimi nr. 172, dt. 14.03.2023 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ka marrë në shqyrtim kërkesën e Partisë Demokratike për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14.05.2023. Në përfundim të shqyrtimit administrativ Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me arsyetimin se mungon një nga elementët e nenit 64, pika 2 të Kodit Zgjedhor, dhe konkretisht deklarata solemne e kryetarit të partisë, ka vendosur mosregjistrimin e Partisë Demokratike me kryetar zotin Lulzim Basha me shkronjat listore PD ose PDSH si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të dt. 14.05.2023. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankesë Partia Demokratike e përfaqësuar nga Indrit Cefa, me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 172 të mësipërm që sapo citova. Nga shqyrtimi, verifikimi paraprak i kërkesës ankimore, verifikohet se është në përputhje me nenin 130 të Kodit Zgjedhor pasi i plotëson të 3 elementët e formës. Kompetenca e KQZ-së për të marrë në shqyrtim vendimet e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve i përket KAS-it. Legjitimitimi i ankuesit, legjitimohet pasi ka interes të ligjshëm në këtë procedurë si dhe ka respektuar afatet ligjore për ankim.

Z. K. Bele: Faleminderit! nëse palët në këtë fazë për pjesën e ankimit nuk besoj se... përveçse të kërkojnë kalim në shqyrtim... Pyetje në këtë fazë nuk kemi. Mirë, KAS tërhiqet për vendim.

Rifillon seanca

Ora 15:23

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.03.2023*

Z. K. Bele: KAS i konsultuar në vend vendosi kalimin për shqyrtim të çështjes dhe cakton si orar dhe datë të seancës ditën e nesërme dt. 16.03.2023, ora 12:00. Me kaq seanca deklarohet e mbyllur, faleminderit!

Vendimi nr. 24

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



RENDI I DITËS

Projektvendim "Shqyrtimi paraprak i Kërkesës Ankimore nr. 33, objekti shfuqizimi i vendimit nr. 172, dt. 14.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Subjekti ankues zoti Sali Berisha".

PJESËMARRJA :


- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Z. Y. Merkaj, Z. E. Mema, znj. I. Osmanaj
- **Parti Politike:** PD (L. Nuraj, F. Nuri)

Z. L. Braho: Çelim seancën për shqyrtimin e elementëve të formës dhe të përmbajtjes së Kërkesës Ankimore nr. 33. Kërkesë ankimore që sipas ankuesit është bërë me objekt ankimi “Kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 172, dt. 14.03.2023 dhe ndryshimin e vendimit duke vendosur regjistrimin e Partisë Demokratike të Shqipërisë, përfaqësuar nga kryetari Sali Berisha, si subjekt zgjedhor në organet e qeverisjes vendore të datës 14.05.2023”. Ka ndonjë kërkesë për regjistrimin e ndonjë pale të interesuar në këtë çështje zoti Merkaj?

Z.Y. Merkaj: Jo nuk ka.

Z. L. Braho: Lidhur me këtë kërkesë janë të pranishëm zoti Ledio Nuraj dhe Franc Nuri. Kërkesa ankimore është e nënshkruar nga zoti Sali Berisha, kështu që

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.03.2023*

dëgjojmë mendimin e Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së në lidhje me këtë kërkesë ankimore dhe më pas i japim fjalën zotit Nuraj.

Z. Y. Merhaj: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 172, dt. 14.03.2023 ka marrë në shqyrtim kërkesën ankimore, me kërkues Partia Demokratike, përfaqësuar nga Kryetari, zoti Lulzim Basha me objekt regjistrimin e Partisë Demokratike si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023. Në përfundim të shqyrtimit administrativ Komisioneri ka vendosur të mos e regjistrojë Partinë Demokratike me kryetar zotin Lulëzim Basha me shkronjat listore PD ose PDSH si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim më Kërkesën Ankimore nr. 33 Partia Demokratike e përfaqësuar nga kryetari zoti Sali Berisha. Nga verifikimi paraprak i elementëve formal të kërkesës konstatohet se nuk plotëson elementët e nenit 130, pasi nuk plotëson elementin b, pikën b, legjitimitimin e ankuesit. Nuk legjitimohet në ngritjen e kësaj kërkesë pasi edhe tek arsyetimi i vendimit të Komisionerit nuk është lëgjitimuar në kërkimet e bëra më këtë çështje. Faleminderit!

Z. L. Braho: Po faleminderit! Ju propozoni mospranimin e kërkesës. Po fjala për ju zoti Nuraj. Në lidhje me këto elementë të kërkesës dhe nëqoftë se keni ndonjë kundërargument në lidhje me atë çfarë parashtroi përfaqësuesi i KQZ-së.

Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së: Ateherë, kërkesa nga ana formale i plotëson të gjitha kërkesat e kërkuara. Edhe nga ana e legjitimitetit, edhe në lidhje me atë që sapo relatoi Sekretarit të Përgjithshëm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në lidhje me vendimin dhe është fakt tashmë që ne si palë kemi depozituar kërkesën për

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.03.2023*

regjistrim të subjektit Partia Demokratike në zgjedhjet e 14 majit me kryetar Sali Berishën. Dokumentacioni jonë, është marrë, është administruar, është pranuar, është futur në seancën dëgjimore apo seancën ku do të vendosej për regjistrimin e Partisë Demokratike. Jemi legjitimuar si palë, jemi dëgjuar si palë gjatë gjithë seancës. Është administruar dokumentacioni edhe në seancë. Dokumentacioni i paraqitur nga Partia Demokratike dhe nuk kemi asnjë lloj shprehje me vendim nga e Komisioneri. Gjatë gjithë kohës është shprehur në lidhje me kërkesën për regjistrim të Partisë Demokratike me kryetar Lulëzim Bashën dhe në asnjë moment nuk është referuar në lidhje me kërkesën tonë dhe në vendim nuk është shprehur. Nëqoftë se do të ishte bërë legjitimiteti apo jo, duhet të ishte bërë që në fillim dhe të mos ishim futur në gjykim. Kështu që ne legjitimohemi dhe jemi palë ankuese në këtë ankim pasi kemi kemi qenë pjesë gjatë gjithë shqyrtimit.

Z. L. Braho: Faleminderit! Ka ndonjë pyetje nga kolegët? Po zoti Çefa.

Z. E. Çefa: Faleminderit! Unë kam një pyetje për Sekretarin e Përgjithshëm. Do të doja e para ta elaboronit pak këtë çështjen e moslegjitimitit sepse nuk e kuptova. Për arsye se ankuesi ka paraqitur një ankim pak ditë më përpara për një vendim të ndërmjetëm që i përket të njëjtës çështje dhe ju e legjitimuat , pra ju propozuat legjitimimin e ankuesit. Meqenëse ishim në të njëjtat kushte për të njëjtën çështje por vendimi ishte i ndërmjetëm. Përveç kësaj ka edhe një vendim të KAS-it të cilin nuk e di pse ndoshta Komisioneri ndoshta nuk e ka marrë, ndoshta dhe nuk është njohur me të, nuk e ka lexuar, i cili i rekomandon Komisionerit që në çështjen e themelit duhet të shprehet për kërkesën e të dy subjekteve pjesëmarrës në këtë procedim, nuk po them e dy partive apo të dy përfaqësuesve të partisë se nuk shkon. Kështu që unë mendoj se ne këtë moment e kemi ezauruar, e kemi mbajtur

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.03.2023*

një qendrim, megjthatë do të kisha dashur, do të kisha vlerësuar shumë një interpretim më të thellë të qendrimit tuaj nga zoti Merkaj.

Z. Y. Merkaj: Atehëre, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka marrë në shqyrtim dy kërkesat e zotit Sali Berisha dhe Partisë Demokratike përfaqësuar nga Indrit Sefa. Në vendimin e ndërmjetëm ka vendosur, ka marrë dy kërkesat dhe ka vendosur të mosregjistrojë dhe të... Në vendimin përfundimtar të datës 14 mars, si kërkues është vetëm Partia Demokratike e përfaqësuar nga zoti Lulzim Basha dhe në arsyetimin e vendimit Komisioneri i ka dhënë dhe përgjigje kërkesës së zotit Sali Berisha, kërkesës drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të regjistruar Partinë Demokratike si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023. Komisioneri ka vlerësuar se në vlerësim paraprak të dy kërkesave është bërë dhe seanca e dt, 09.03.2023 dhe është thënë se zoti Sali Berisha nuk e ka legjitimitetin për të kërkuar regjistrimin e Partisë Demokratike në zgjedhje si subjekt zgjedhor.

Z. I. Rusmali: Por përse nuk e jep me vendim këtë gjë?

Z. Y. Merkaj: Me vendim e ka bërë arsyetimin.

Z. I. Rusmali: Arsyetimi nuk është vendim. Vendim është dispozitivi. Ai është konstatim. Duhet një urdhërim që këta të shfrytëzojnë të drejtën e tyre të ankimit se nuk ke pse ti mohosh të drejtën e ankimit palës. Pse nuk ndodh kjo? Ne e kërkuam që ta bëjë me urdhërim, bëhet gjithçka në rregull, nuk ka ndonjë gjë të keqe. Ne nuk jemi duke atakuar arsyetimin e Komisionerit, ne mezi presim që ai ti japë formë. Jepi formë dhe na jep mundësinë ta shqyrtojmë. Se kjo histori kështu, ky

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.03.2023*

Iloj ping-pongu është i papranueshëm për ekstensionet me thënë të drejtën. Çfarë sensi ka? Kanë bërë një kërkesë, duhet të marrin një përgjigje. Dhe përgjigja nuk është arsyetimi. Komisioneri ka bërë bashkimin e dy kërkesave. Është e vërtetë?

Pa mikrofon, nga salla: Po.

Z. I. Rusmali: Si mundet pa e marrë vesh njeri të shndërrohet në një kërkesë të vetme? Ke bërë bashkimin e dy kërkesave, do të japësh përgjigjen për të dy kërkesat. Ndaji po të duash se je organ sovran, por do të japësh përgjigje. Do të thuash shqyrtova të parën dhashë përgjigje, po merrem me të dytën dhe do të jap një përgjigjen. Por kjo lloj sjellje kështu sikur fshehurazi, të përjashtojë fshehurazi. Përse do të përjashtosh fshehurazi? Ke pasiguri? Ke ndonjë gjë që nuk të shkon?

Z. E. Çefa: Kam pyetje të tjera.

Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së: Edhe në seancën e parë vet Komisioneri, në fjalën e tij arsyetuese tha që edhe në perceptimin tim Sali Berisha është kryetari i Partisë Demokratike. Që do të thotë jo në perceptimin personal, por në perceptimin si organ, sepse nuk është organ kolegjal dhe ai po fliste për veten. Është mono, kështu që edhe në arsyetimet e po këtij vendimi edhe në vijim përsëri ka përmendur, gjatë arsyetimit ka marrë si referim, thotë “Kur është rasti për të legjitimuar kërkesën për regjistrim të PD-së si subjekt zgjedhor kundrejt pretendimit të zotit Sali Berisha se është ai që ka legjitimitetin për të kërkuar regjistrimin e PD-së si subjekt zgjedhor, nga i autorizuari i zotit Lulzim Basha dhe përfaqësuesi i PD-së në KQZ zoti Sefa sjell si prove faktet juridike etj.”, që do të

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.03.2023*

thotë ne kemi qenë pjesë e debatit, pjesë e arsyetimit dhe pjesë e procesit dhe bashkimi është marrë po me vendim nga Komisioneri për të na bashkuar të dyja kërkesat dhe të quheshin një.

Z. E. Çefa: Zoti Nuraj një pyetje meqenëse nuk është e nevojshme por gjithsesi për transparencë. A keni depozituar prova gjatë procedimit administrativ të zhvilluar nga Komisioneri?

Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së: Po i nderuar, kemi dokumentacionin përkatës.

Z. E. Çefa: Dhe janë pranuar?

Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së: Absolutisht që po,

Z. E. Çefa: Faleminderit, nuk kam pyetje të tjera.

Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së: Dhe janë referuar gjatë dorëzimit me listim.

Z. L. Braho: Ka pyetje të tjera?

Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së: Mund të bëj dhe një kërkesë proceduriale?

Z. L. Braho: Po.

Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së: Duke parë, duke ndjekur gjithë normat dhe doktrinën dhe normat e gjykimit administrativ, duke parë që interesi është i njëjtë

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.03.2023*

për të dyja kërkesat, duke parë që dhe Komisioneri ka marrë dhe i ka bashkuar të dyja kërkesat në një gjykim të vetëm. Duke paraparë, pa dashur të paragjykoj vendimet e KAS-it këtu, por duke paraparë që jemi dy kërkues, do të kemi dy vendime të ndryshme, nëse mundet të jepet, vendimi i dikujt mund të paragjykojë vendimmarrjen e kërkuesit tjetër që mund të jetë vënë mbrapa në rradhe apo më para në rradhë do të kërkonim këtu përpara jush dhe të administrohej si kërkesë që edhe gjykimi i kësaj çështjeje, të dyja kërkesat të gjykohej në një gjykim të përbashkët, siç dhe ka ardhur deri më tani dhe nisur dhe nga praktika që ka ndjekur KAS-i deri më sot që në gjykimet që janë bërë të përbashkëta ka mbajtur qendrimet e veta pro kësaj që po kërkoj unë. Faleminderit!

Z. L. Braho: Ka pyetje tjetër? Po zoti Sefa.

Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së: Më fal por zoti Sefa nuk është fare palë këtu ku po flasim nuk ishte as palë e interesuar as e legjitimuar, kështu që...

Pa mikrofon, nga salla: Nuk dëgjohet.

Z. L. Braho: KAS tërhiqet për vendim.

Rifillon seanca

Ora 15:46

Z. L. Braho: KAS pasi u tërhoq për vendim, vendosi në bazë të nenit 129, pika 3, shkronja a e Kodit Zgjedhor, kalimin e kërkesës ankimore nr. 33 për shqyrtim dhe po ashtu në bazë të nenit 132 të Kodit zgjedhor vendosi bashkimin e shqyrtimit

**Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.15.03.2023*

administrativ të Kërkesës Ankimore nr. 33 me Kërkesën Ankimore nr. 32. Shqyrtimi i të dyja kërkesave do të bëhet nesër në datën 16.03.2023 ora 12:00. Seanca deklarohet embyllur dhe relator do të jetë zoti Koli Bele që është relator i kërkesës së parë ankimore. Seanca deklarohet e mbyllur.

Vendimi nr. 25

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*

